



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR
MIRATIMIN E FORMATEVE TË STANDARTIZUARA TË RAPORTIT TË AUDITIMIT TË
FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË VITIT
KALENDARIK, RAPORTIT TË AUDITIMIT TË FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË
SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE DHE RAPORTIT TË
MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore

Baza Ligjore: Neni 21, pika 1, neni 91, pika 1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, gërma "a", neni 23/2, neni 24/4, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000," Ligji për Partitë Politike" i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Në zbatim të nenit 15/2, pika 2, gërma a, e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të hartojë

Nr. 152 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e vendimit



"Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"

dhe miratojë rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike si edhe formatet e standartizuara për raportimin financiar vjetor.

Në bazë të nenit 23/2, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me short për çdo parti politike, ekspertë kontabël të licensuar të cilët do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik. Raporti i auditimit paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar prej këtij komisioni në vendimin e caktimit të ekspertëve kontabël të licensuar.

Nga zbatimi në praktikë i rregullave për raportimin financiar nga ekspertët kontabël të licensuar lind i nevojshëm miratimi i një formati të standartizuar, i cili fokusohet në përmbajtjen e raportit të auditimit për raportin vjetor të partisë politike. Ky model synon të përfshijë të gjitha transaksionet financiare të bëra nga secila parti politike në bazë vjetore, me përjashtim të transaksioneve të fushatës zgjedhore të cilat duhet të llogariten në raportin e financimit të fushatës zgjedhore. Formatin parashikon dhe rubrikat përkatëse për raportimin e ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar. Qëllimi i kësaj është pasja e një formati gjithëpërfshirës dhe transparent për financat e partive politike.

Bazuar në nenin 24/4 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se dita e fillimit të fushatës zgjedhore përcakton me short një numër të mjaftueshëm ekspertësh financiarë, për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë, dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore.

Raporti i monitorimit i paraqitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit, por në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Raporti detajon në mënyrë të plotë të gjitha aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet që ka përdorur partia politike gjatë fushatës zgjedhore, kostimin e tyre.

Bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licensuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore.

Raporti i auditimit paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit.

Nga zbatimi në praktikë i rregullave të monitorimit të fushatës zgjedhore dhe raportit të auditimit të fushatës zgjedhore nga eksperti kontabël i licensuar, lind nevoja për miratimin e modeleve të formateve të standartizuara të raporteve të monitorimit dhe auditimit të fushatës zgjedhore.

Modeli 1 përmban rregullat dhe mënyrën e raportimit të auditimit për raportet e fushatës të financimit të zgjedhjeve. Ky model i raportit të auditimit së bashku me modelin për raportet vjetore të partive politike garantojnë informacion të plotë dhe pa dublikate.

Modeli 2 ofron rregulla dhe mjete pedagogjike për ekspertët financiarë për të krijuar një metodologji të qëndrueshme dhe uniforme në monitorimin e fushatës zgjedhore. Qëllimi është zhvillimi i procedurave të standardizuara që mundësojnë krahasimin mes raporteve të ndryshme të subjekteve zgjedhore, por gjithashtu edhe për të hartuar një mjet kontrollues që mund të ndahet me audituesit përgjegjës për auditimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore të të njëjtit subjekt zgjedhor.



Nr. 152 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e vendimit

"Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"

Modeli 3 përmban rregullat dhe mënyrën e raportimit të raportit të auditimit për raportin vjetor të partisë politike. Ky model synon të përfshijë të gjitha transaksionet financiare të bëra nga secila parti politike në bazë vjetore, me përjashtim të transaksioneve të fushatës zgjedhore të cilat duhet të llogariten në raportin e financimit të fushatës zgjedhore. Qëllimi i kësaj është pasja e një tabloje gjithëpërfshirëse dhe transparente të financave të partisë.

Miratimi i formateve tip synon:

- Rritjen e transparencës në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për qëllime të fushatës zgjedhore, duke qenë se formati përmban detaje të hollësishme si për të ardhurat, shpenzimet ashtu edhe për kufizimet. Gjithashtu formati pas hartimit do të dorëzohet në KQZ dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.
- Lehtësimin dhe unifikimin e raportimit nga audituesit ligjor për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për qëllime të fushatës zgjedhore apo gjatë vitit kalendarik. Lehtësimin dhe unifikimin e raportimit nga ana e ekspertëve financiar për monitorimin e fushatës.
- Lehtësimin e përpunimit të informacionit nga ana e strukturës së posaçme në KQZ për shqyrtimin e raporteve financiare dhe kryerjen e verifikimeve përkatëse.

Qëllimi kryesor i këtyre tre modeleve është të ndihmojë audituesit dhe ekspertët financiarë në kryerjen e detyrave të tyre në një mënyrë të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe sistematike.

Miratimi i formateve ka për qëllim të ndihmojnë edhe partitë politike dhe kandidatët që të përmbushin kërkesat ligjore duke raportuar saktë transaksionet e tyre financiare.

Plotësimi i formularëve tip do të bëhet në mënyrë elektronike dhe do të dorëzohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si elektronikisht ashtu edhe në format të printuar.

Formatet e standartizuara janë hartuara në bashkëpunim me ekspertët e NDI dhe KIE, të cilët japin detaje për strukturat e raporteve të auditimit vjetor, monitorimit dhe auditimit të fushatës zgjedhore.

Formatet e standartizuara ofrojnë udhëzime për ekspertët kontabël të licensuar për të krijuar një metodologji të qëndrueshme dhe uniforme për auditimit vjetor, monitorimit dhe auditimit të fushatës zgjedhore.

Përpara miratimit nga KQZ, të formateve të standartizuara, janë zhvilluar dhe takime konsultative me financierët e partive politike, përfaqësues nga Organizata të Shoqërisë Civile, auditues ligjorë. Varianti i paraqitur ka të përfshirë sugjerimet dhe rekomandimet e dala nga takimet e konsultimit.

PËR KËTO ARSYE:

Neni 21, pika 1, neni 91, pika 1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar neni 15/2, neni 23/2, neni 24/4, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000," Ligji për Partitë Politike" i ndryshuar.



Nr. 152 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e vendimit

"Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat për formatin e standartizuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore sipas modelit nr. 1, bashkëlidhur.
2. Të miratojë rregullat për formatin e standartizuar të raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore, sipas modelit nr.2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë rregullat për formatin e standartizuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara të partive politike për vitin kalendarik sipas modelit nr. 3, bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 152 i Vendimit Data 11.04.2019 e Vendimit Ora 12:00 e vendimit

“Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”